Kronikë

Vrasje brenda Komisariatit Nr.3 në Tiranë! Pas sherrit, polici 25-vjeçar qëllon për vdekje kolegun e tij! Viktima mbi 20 vite në Policinë e Shtetit

Komisariati Nr.3 në Tiranë është shndërruar në një vend krimi! Efektivi i policisë Ludjan Zaimi 25-vjeç ka qëlluar për vdekje me armën e shërbimit kolegun e tij, Çaush Saliasi, 55-vjeç.

HOROSKOPI

Lajmi i fundit
Marrëveshja për Butrintin, Zhupa në '5 pyetjet': Nuk është në interes të publikut! Një park kombëtar s'mund t'la lësh privatit, historia nuk jepet me koncesion
23 Maj, 22:33

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
23 Maj, 21:40 | **Përditësimi i fundit: 23 Maj, 22:37**

TIRANË: Komisariati Nr.3 në Tiranë është shndërruar në një vend krimi! Efektivi i policisë Ludjan Zaimi 25-vjeç ka qëlluar për vdekje disa herë me armën e shërbimit kolegun e tij, Çaush Saliasi, 55-vjeç, të dy me detyrë oficerë të Patrullës së Përgjithshme. Saliasi u dërgua me urgjencë në spital, por fatë të keq ndërroi jetë si pasojë e plagëve të marra. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 21:20 në ambientet e brendshme të komisariatit, konkretisht në zyrën e instruktazhit ku ndarja e turneve.

Nuk dihen ende shkaqet e kësaj ngjarjeje të rëndë, ku ajo që raportohet deri më tani nga gazetari Sokol Dema, është se autori dhe viktima janë konfliktuar edhe më herët.

LEXO EDHE:
JA HARTA/ E lirë vetëm Unaza e Madhe dhe Rruga e Elbasanit, hermetizohet Tirana më 25 maj

Autori Ludjan Zaimi është ndaluar nga Policia ku po merret në pyetje. Zaimi ka 1 vit e gjysmë në Policinë e Shtetit, e ndërsa viktima Çaush Saliasi mbi 20 vite karrierë me Uniformat blu. Në komisariatin Nr. 3 ka mbërritur edhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, Gledis Nano, si edhe një grup i posaçëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, përfshirë ekspertë të Drejtorisë së Standardeve Profesionale dhe nga Departamenti i Rendit dhe Sigurisë Publike.

Komisariatet e Policisë janëvë të fundit janë shndërruar në skena krimi. Ngjarja e kësaj të hëne, pason një tjetër ngjarje kriminale brenda Komisariatit. Bëhet fjalë për vetëvrasjen e ndodhur në Komisariatin e Kavajës u vetëvra *Ilvi Meta*, teksa në atë të *Kamzës* iu vu flaka gjatë tentativës së arrestojes.

Lajmi në përditësim

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 21:57

U qëllua nga kolegu brenda Komisariatit Nr.3, ndërron jetë në spital efektivi

Report Tv mëson se efektivi i policisë që u qëllua nga kolegu i tij, Çaush Saliasi ka ndërruar jetë në spital.

Ora 21:56

Të shtënat me armë zjarri brenda komisariatit, dalin emrat e përfshirë në konflikt

Report Tv ka mësuar emrat e policëve që u përfshin në një konflikt brenda Komisariatit nr.3 në Tiranë. Mësohet se autori është efektivi Ludian Zaimi, teksa i plagosuri është Çaush Saliasi.

B.K./Shqiptarja.com

TAG: Tiranë Ludjan Zaimi Çaush Saliasi

Komento

Komente

Oficer: 23/05/2022 22:20

Mos rekrutoni ne police hajdute e kriminel e bashkepunitor bandash, Se skane ndodh ne histori kto qe po ndodhin kto kohet e fundit!!! Sa vjen e shkatrrohet policia dhe cdo institucion Qe i kane mbush me hajdute e prostituta eskorte..

Përgjigju

Drini: 23/05/2022 22:04

Me shkoi goja mbrapa : largoni drejtorin e policise se Tiranes Lorenc Panganika sepse e ka autoritetin zero perpara ekipit te policise e njodhimisht policia ne Tirane eshte perfshire ne kaos. Kujioni dhunon ndaj te rinjve per rritjen e crimineve, dy vetvrasjet ne komisariat dhe kjo e fundit eshte thagme.

Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
A bënë zgjedhjen e duhur demokratët duke rikthyer në krye Sali Berishën?
Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

Kronikë

Policia e Tiranës aksion kundër shoferëve të papërgjegjshëm, hiqen 113 leje drejtimi dhe procedohen penalisht 32 drejtues mjetesh
23 Maj, 14:41

Sport



VIDEO/ 'Mirëseviní në Tiranë', UEFA publikon pamje të kryeqytetit në prag të finales së Ligës së Konferencës
23 Maj, 13:50

Sociale

OSHEE njoftón ndërprerjen e energjisë në disa zona të Tiranës për sot dhe nesër, shkak bëhen punimet në rrjet
23 Maj, 12:34

Kronikë

Ushtronte dhunë ndaj bashkëshortes, arrestohet 40 vjeçari në Tiranë, me pranga dhe i vëllai
23 Maj, 12:27

Sport

Milan fiton kampionatin pas 11 vitesh! Shqiptarët festa edhe në Tiranë, tifozët kuqezinj i vënë 'flakën' kryeqytetit (VIDEO)
Ernest Koçi
22 Maj, 20:10

Kronikë

Babai denoncon zhdukjen e djalit të tij 30-vjeçar, 24 vjeçari dhunon të dashurën! 6 të prangosur në Tiranë
22 Maj, 13:13

Kronikë

Rjedhje gazi në një pikë gazi te kryqëzimi i Misto Mames në Tiranë, policia ndalon qarkullimin e makinave dhe këmbësorëve
21 Maj, 21:32

Sociale

Tiranë/ Brenda 3 javëve aksidentohen 4 autobusë! Qyteterët të pasigurt: Shoferët të alkoolizuar e të papërgjegjshëm! Memaj: Urbanët janë të kolauduar, drejtuesit të trajnuar
Erxhi Musaj
21 Maj, 18:27

Sociale

Tirana 'vishet' me ngjyrat e ylberit, komuniteti LGBTQI mbajti 'Paradën e Krenarisë'! Aktivistja: Jemi familjet! E pranishme edhe Kim! Ambasadorja e Suedisë: Dashuria, për të gjithë
21 Maj, 11:15

Kronikë



Vidhnin automjete në Tiranë më ané të celësave të klonuara, arrestohen 3 të rinj, në kërkim 2 të tjerë
21 Maj, 10:31

Sport

Finalja e Conference League/ 'Pa një biletë për ndeshjen nuk futeni në Tiranë', thirrja e Veliajt: Protokolli si në vizitën e Bush dhe Papës
21 Maj, 09:42

Ekonomi

SPECIALE/ Finale luksi në Tiranë, fatura e fjetjes 3 mijë euro! Ekspertët: Më lirë 1 avion privat se 1 dhomë hoteli! Çmimet jo etike! Politika e ndarë, Veliaj: Normale! Braçe: Po turp nuk kem!?
Eliza Gjediku
Vilka Kamenica
21 Maj, 09:25

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i pasaturizuar i kesaj faqeje